



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 15 dhjetor 2022
Nr. ref.:RK 2096/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI72/21

Parashtrues

Gylten Krasniqi, Nurten Haskuka dhe Ajser Vuqitërna

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. nr. 458/2020, të 16 dhjetorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gerxhaliu -Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gylten Krasniqi, Nurten Haskuka dhe Ajser Vuqitërna, nga Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtrueset e kërkesës), të cilat i përfaqëson Mustafë Kastrati, avokat nga Peja.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtrueset e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 458/2020] të 16 dhjetorit 2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 914/17] të 13 majit 2020, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 979/15] të 16 dhjetorit 2016, të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Aktgjykimin e kontestuar parashtrueset e kërkesës e kishin pranuar më 4 shkurt 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtrueseve të kërkesës, të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 prill 2021, parashtrueset e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 prill 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 28 prill 2021, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtrueseve të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë formularin zyrtar të kërkesës dhe autorizimin që dëshmon që ai i përfaqëson parashtrueset e kërkesës para Gjykatës.
9. Më 14 maj 2021, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtrueseve të kërkesës autorizimin që dëshmon që ai i përfaqëson parashtrueset e kërkesës para Gjykatës si dhe formularin e plotësuar të kërkesës.
10. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

11. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KSH. KI72/21 përcaktoi që gjyqtarja Selvete Gërzhaliu-Krasniqi të caktohej gjyqtare raportuese në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
12. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 12 korrik 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzojë fletëkthesën që dëshmon kohën kur parashtrueset e kërkesës e kanë pranuar Aktgjykimin e kontestuar.
14. Më 22 korrik 2021, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore fletëkthesën e kërkuar.
15. Më 15 nëntor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 11 qershor 1991, babai i parashtrueseve të kërkesës H.T., kishte ndërruar jetë. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se babai i parashtrueseve të kërkesës H.T. kishte lënë si masë trashëgimore disa ngastra kadastrale.
17. Më 27 prill 2005, parashtrueset e kërkesës, kishin hequr dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarit B.T., vëllai i parashtrueseve të kërkesës. Gjykata Komunale në Prizren, pas zhvillimit të procedurës trashëgimore të H.T., nxori Aktvendimin [T. nr. 107/05] përmes të cilit u shpall trashëgimtar B.T., në ngastrat kadastrale [nr.7170-1] dhe [7170-2], pjesën prej 4/5, sipas listës poseduese nr. [7244] ZK Prizren dhe parcelën kadastrale [7169-1], sipas listës poseduese [6661] ZK Prizren.
18. Më 30 dhjetor 2013, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [T. nr. 107/05] vendosi për ndarjen e një pjesë të pasurisë të identifikuar më vonë, në të cilën trashëgimtarë ishin shpallur edhe parashtrueset e kërkesës.
19. Më 18 shtator 2015, parashtrueset e kërkesës parashtruan padi në Gjykatën Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), të cilën e precizuan më 13 tetor 2015, duke kërkuar që të anulohet deklarata për heqje dorë të trashëgimisë në procedurën trashëgimore të 27 prillit 2005 me arsyetimin se deklarata për heqje dorë e kanë dhënë nën lajthim, mashtrim dhe nën premtim, si dhe të vërtetojë të drejtën e pronësisë mbi bazën e trashëgimisë në një pjesë të ngastrës kadastrale [nr. 7170/4].
20. Më 16 dhjetor 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 979/15], refuzoi padinë e parashtrueseve të kërkesës me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për anulimin e deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia dhe se nuk ka ndonjë provë që parashtrueset e kërkesës kanë qenë nën kërcënim apo kanosje në momentin kur është shprehur vullneti për të hequr dorë nga një pjesë të trashëgimisë. Për më tepër, Gjykata Themelore konkludoi: *“...se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar ekzistimi i mashtrimit apo lajthimit”*.

21. Gjykata Themelore, ndër të tjera, arsyetoi se duke u bazuar në nenin 138 [Parashkrimi i së drejtës për të kërkuar pasurinë trashëgimore] të Ligjit për trashëgiminë, padia e parashtrueseve të kërkesës është paraqitur jashtë afatit dhjetëvjeçar që nga plotfuqishmëria e Aktvendimit [T. nr. 107/05] të 27 prillit 2005.
22. Parashtrueset e kërkesës u ankuan në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [C. nr. 979/15], për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 13 maj 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [AC. nr. 914/17], e refuzoi ankesën e parashtrueseve të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 979/15] me arsyetimin se nuk është vërtetuar fakti se parashtrueset e kërkesës me rastin e heqjes dorë nga trashëgimia iu është cenuar shprehje e lirë e vullnetit të tyre.
24. Parashtrueset e kërkesës parashtruan revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [AC. nr. 914/17], për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
25. Më 16 dhjetor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 458/2020] e refuzoi si të pabazuar revizionin me arsyetimin se: *“...me asnjë provë nuk është provuar se me rastin e dhënies së deklaratave trashëgimore, paditësit kanë pasur të cenuar vullnetin e lirë dhe se ky vullnet të jetë me dhënë me të meta siç është lajthimi, mashtrimi apo ekzistimi i ndonjë rrethane e cila e ka penguar ose shtrembëruar vullnetin e lirë [...]”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtrueset e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta me vendimet e tyre kanë shkelur nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
27. Gjykata në vijim do t'i paraqes pretendimet e parashtrueseve të kërkesës ashtu siç i kanë reflektuar në kërkesën e tyre:

Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

28. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, parashtrueset e kërkesës theksojnë se: *“...është shkelur neni 31, par.1 i Kushtetutës sepse çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave para organeve kompetente, kurse në rastin konkret me vendimet e kundërshtuara kjo e drejtë nuk u është garantuar paditësve [...]”*.
29. Parashtrueset e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta me rastin e refuzimit të padisë se tyre, gabimisht janë bazuar në nenin 20, 21 dhe 36 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike dhe nenin 93 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore me arsyetimin se rasti nuk kishte të bënte me vërtetim pronësie por me anulim të deklaratës trashëgimore.

30. Parashtrueset e kërkesës përgjatë pretendimeve të tyre nënvizojnë specifikisht se: *“...nuk kanë hequr dorë nga trashëgimia por duke u bazuar në veprimet me lajthim, duke i marrë motrat e veta në shpejtësi për nënshkrim dhe duke pasur besim pozitiv në te pasi e kanë vëlla ia kanë besuar cedimin e pjesës trashëgimore, mirëpo pasi që është kryer një akt i tillë me keqbesim, lajthim dhe mashtrim, këtu kemi të bëjmë me vepër penale dhe deklarata nule që nuk prodhojnë efekt juridik duke i vu në lajthim se pasi të ndërtoj objektin do t’ua jap pjesën e tyre trashëgimore”*.
31. Parashtrueset e kërkesës tutje theksojnë se në mungesë të njohurive kanë firmosur deklaratën për heqje dorë nga trashëgimia dhe pasi vëllai i tyre iu kishte premtuar se do t’ua jepte nga një banesë të cilat ishin planifikuar të ndërtohen në pronën në fjalë.
32. Në lidhje me arsyetimin e gjykatave të rregullta, parashtrueset e kërkesës theksojnë: *“Gjykatat kanë konstatuar se në këtë çështje ka parashkrim, duke u bazuar në nenin 182.1 të LTK_së, mirëpo gjykatat bien në kundërshtime me vetveten pasi që vetë e cekë në arsyetim të aktgjykimeve se duke u bazuar në Nenin 138.2 "se ndaj poseduesit me keqbesim e drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore parashkruhet brenda afatit prej 20 viteve", dhe këtu kemi të bëjmë me keqbesim dhe jo mirëbesim, për këtë arsye edhe paditësit kanë kërkuar anulimin e deklaratës trashëgimore pasi që është kryer me lajthim dhe mashtrim, dhe kjo i përket keqbesimit në thelb dhe jo mirëbesimit ashtu siç cekin gjykatat, andaj nuk ka parashkrim”*.
33. Në këtë kontekst, parashtrueset e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre kanë dështuar që të bëjnë dallimin në mes cedimit dhe heqjes dorë nga trashëgimia dhe kjo, sipas tyre, rezulton në arsyetim kontradiktor të vendimit dhe rrjedhimisht përbën shkelje të shkronjës (n) të paragrafit 2 të nenit 182 të LPK-së.
34. Në këtë aspekt, parashtrueset e kërkesës venë theksin mbi atë se: *“...duke u bazuar në nenin 139 të LTK-së, paragrafi 1, 2 dhe 3, e drejta për ndarjen e trashëgimisë nuk parashkruhet dhe trashëgimtarët ligjor të cilët heqin dorë nga e drejta që të kërkojnë ndarjen e trashëgimisë si dhe dispozitat me të cilat ndalohet ose kufizohet ndarja janë nule dhe si të tilla nuk prodhojnë efekt juridik”*.
35. Në vazhdim, parashtrueset e kërkesës theksojnë se: *“Neni 132. 2 i LTK-së cekë se “heqja dorë në dobi të trashëgimtarit ligjor të cilët heqin dorë nga trashëgimia, por si deklaratë për cedimin e pjesës trashëgimore tek trashëgimtari i caktuar”*.
36. Parashtrueset e kërkesës tutje pretendojnë se: *“Nuk janë vlerësuar në parimin e barazisë në mes provave deklaratat e paditëseve të dhëna në procedurën e shkallës së parë, duke cenuar paanshmërinë e Gjykatës dhe duke i dhënë relevancë vetëm deklaratimit të të paditurit, përkatësisht duke u thirrur në rrethana se nuk paska pasur të meta në vullnetin e paditëseve [...]”*.
37. Sipas parashtrueseve të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë tejkalluar *“objektin e kërkesëpadisë duke u marrë me afatshmërinë e saj kurse paditë për anulim nuk i nënshtrohen afateve, dhe duke shtrembëruar objektin e kërkesëpadisë nga anulimi i kontratës më vëtetim pronësie”*.

Pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës

38. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës, të njëjtat theksojnë se: *“Është shkelur neni 46 1.2.3 i Kushtetutës sepse e drejta e pronës është e garantuar me Kushtetutë dhe shfrytëzimi i saj rregullohet me ligj të cilat në këtë procedurë nuk janë zbatuar ndaj paditësve duke u privuar arbitrarisht nga prona”*.

Pretendimet përkitazi me shkelje të nenit 22, 24 dhe 53 të Kushtetutës

39. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 22 të Kushtetutës, parashtrueset e kërkesës theksojnë: “[...] Është shkelur neni 22 paragrafi 1 pika 6 e Kushtetutës sepse me mos njohjen e të drejtës në trashëgimi për këtu paditësit- vajzat e të ndjerit dhe marrjen e trashëgimisë vetëm nga vëllai është kryer diskriminim ndaj gjinisë femërore dhe shkelja e parimit kushtetues se edhe vajzat janë të barabarta në trashëgimi, e me çka është shkelur konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”.
40. Ndërsa, sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës, parashtrueset e kërkesës theksojnë se: “Është shkelur neni 24, para 1 sepse askush nuk mund të diskriminohet mbi baza pronësore, gjinore apo pronësore”.
41. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 53 të Kushtetutës, parashtrueset e kërkesës theksojnë se: “Është shkelur neni 53 i Kushtetutës sepse të drejtat e kërkuara të paditësve për trashëgiminë e babait janë të garantuara me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe këto të drejta duhet të interpretohen në harmoni me këto vendime”.
42. Në fund, parashtrueset e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: (i) kërkesën e tyre të shpallin të pranueshme; dhe (ii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e kontestuar.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i

- nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*
4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
 5. *Prona intelektuale mbrohet me ligj*

Ligji nr. 2004 / 26 për Trashëgiminë i Kosovës, të 1 gushtit 2006, i ndryshuar dhe i plotësuar përmes Ligjit nr. 06/l-008 të 18 dhjetorit 2018

Përmbajtja e deklaratës mbi heqjen dorë nga trashëgimi
Neni 133

133.1. Heqja dorë nga trashëgimi nuk mund të jetë e pjesshme apo me kusht.

133.2. Heqja dorë në dobi të trashëgimtarit të caktuar nuk konsiderohet si heqje dorë nga trashëgimi, por si deklaratë për cedimin e pjesës trashëgimore tek trashëgimtari i caktuar.

Heqja dorë nga trashëgimi që nuk është hapur
Neni 134

Heqja dorë nga trashëgimi që nuk është hapur nuk ka kurrfarë efekti juridik.

Parevokueshmëria e deklaratës për heqjen dorë
ose për pranimin e trashëgimit dhe nulimi i saj
Neni 135

135.1. Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi ose për pranimin e trashëgimit nuk mund të revokohet.

135.2. Trashëgimtari që ka dhënë deklaratën mund të kërkojë nulimin e kësaj deklaratë, po që se ajo është dhënë me kanosje, dhunë, për shkak të mashtrimit ose lajthimit.

Parashkrimi i së drejtës për të kërkuar pasurinë trashëgimore
Neni 138

138.1. E drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet ndaj poseduesit me mirëbesim brenda një viti nga dita që trashëgimtari ka marrë dijeni për të drejtën e vet dhe për poseduesin e sendeve nga pasuria trashëgimore dhe në çdo rast jo më vonë se 10 vjet duke llogaritur për trashëgimtarin ligjor nga dita e vdekjes e trashëgimlënësit, kurse për trashëgimtarin me testament nga shpallja e testamentit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

43. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

44. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

45. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtrueset e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatit]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...].”

46. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtrueset e kërkesës janë palë të autorizuara; i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion; e kanë qartësuar aktin e autoritetit publik, kushtetutshmërinë e të cilit e kontestojnë dhe të drejtat kushtetuese të cilat pretendojnë se u janë cenuar, si dhe e kanë dorëzuar kërkesën në kohë.

47. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtrueset e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e

pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

48. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
49. Në këtë kontekst, dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në rrethanat e këtij rasti, vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtrueseve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
50. Gjykata rikujton se përgjatë gjithë procesit gjyqësor, çështja kryesore ishte anulimi/kontestimi i deklaratave trashëgimore nga parashtrueset e kërkesës me të cilat kishin hequr dorë nga trashëgimia në favor të trashëgimtarit B.T., respektivisht vëllait të tyre, përmes Aktvendimit [T. nr. 107/05] të 27 prillit 2005. Sipas parashtrueseve të kërkesës, deklaratat për heqje dorë nga trashëgimia ishte dhënë nën lajthim, mashtrim dhe nën premtim. Në vitin 2015, parashtrueset e kërkesës ngritën padi në Gjykatën Themelore për vërtetim të pronësisë mbi bazën e trashëgimisë dhe anulimin e deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia me arsyetimin se ishte dhënë nën kanosje, lajthim dhe nën premtim. Në shqyrtimin e kërkesës së tyre, Gjykata Themelore, e Apelit dhe ajo Supreme refuzuan ankesat e parashtrueseve të kërkesës me arsyetimin kryesor se, përveç tjerash, ato kishin dështuar që të argumentojnë se me rastin e heqjes dorë nga trashëgimia iu është cenuar shprehje e lirë e vullnetit të tyre në kuptim të nenit 135 të Ligjit për Trashëgiminë dhe se padia e parashtrueseve të kërkesës është e paafatshme në kuptim të nenit 138 të po të njëjtit ligj. Përfundimet e gjykatave të rregullta që rezultuan në mosanulimin e deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia, parashtrueset e kërkesës i kontestojnë para Gjykatës duke pretenduar shkelje të nenit 22, 24, 31, 46 dhe 53 të Kushtetutës.
51. Gjykata sjellë në vëmendje pretendimet e parashtrueseve të kërkesës se vendimet e gjykatave të rregullta u kanë shkelur atyre të drejtat e garantuara me nenet kushtetuese në vijim: nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
52. Gjykata do t'i adresojë veç e veç secilin nga këto pretendime, që kanë të bëjnë me të **(i)** drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, **(ii)** të drejtat pronësore, dhe **(iii)** barazinë para ligjit.

53. Gjykata, në vijim, do t'i trajtojë veç e veç, në mënyrë kronologjike, secilin pretendim të parashtrueseve të kërkesës duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Pretendimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

54. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, parashtrueset e kërkesës theksojnë në esencë se gjykatat e rregullta me vendimet e tyre kanë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese me rastin e mosanulimit të deklaratës trashëgimore për heqje dorë nga trashëgimia e H.T., në favor të vëllait të tyre B.T., në procedurën e zhvilluar më 27 prill 2005 në Gjykatën Komunale, pasi që deklaratat për heqje dorë nga trashëgimia është dhënë nën kanosje, dhunë dhe mashtrim dhe rrjedhimisht iu është pamundësuar marrja e trashëgimisë që iu takon me ligj.
55. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtrueset e kërkesës theksojnë se: *“...është shkelur neni 31 par.1 i Kushtetutës sepse çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave para organeve kompetente, kurse në rastin konkret me vendimet e kundërshtuara kjo e drejtë nuk u është garantuar paditësve [...]”*.
56. Gjykata vëren se parashtrueset e kërkesës përgjatë gjithë procesit gjyqësor kishin pretenduar se deklaratat për heqje dorë nga trashëgimia ishte firmosur në mungesë të njohurive, nën lajthim, kanosje dhe nën premtim.
57. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se me rastin e inicimit të padisë për anulimin e deklaratës trashëgimore, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 979/15] të 16 dhjetorit 2016, kishte konstatuar si në vijim:

“Në bazë të të gjitha provave të administruara, gjykata konstaton se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar ekzistimi i mashtrimit apo lajthimit të pretenduar. Edhe po të ekzistonte lajthimi sipas vlerësimit të gjykatës, i njëjti nuk ka mundur të ketë efekt juridik, pasi që sipas dispozitave ligjore të sipërcituara heqja dorë nga trashëgimia nuk mund të bëhet me kusht dhe nuk ka mundur të merret si deklaratë e rregullt kjo as nga ana e gjykatës trashëgimore, po të ishte shënuar ky kusht në deklaratat e palëve këtu paditëses me rastin e heqjes dorë nga trashëgimia. Po ashtu edhe po të supozohet së ka pasur mungesë të shprehjes së vullnetit për shkak të lajthimit apo mashtrimit, sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës civile (pasi që në këtë rast do të vinin në zbatim rregulla të veçanta sa i përket anulimit të deklaratës trashëgimore), kjo deklaratë do të ishte relativisht e pavlefshme, dhe nuliteti i saj për arsye të tilla do të mund të kërkohej në afat prej 1 (një) viti, respektivisht e drejta e tillë do të humbte me kalimin e afatit prej 3 (tre) vjetësh.”

58. Në vazhdim, Gjykata e Apelit në Aktgjykimin [AC. nr. 914/17] e 13 majit 2020 lidhur me pretendimet e parashtrueseve të kërkesës, vlerësoi si në vijim:

“Nuk është provuar fakti se me rastin e dhënies së deklaratave trashëgimore nga paditësit në procedurën e zhvilluar trashëgimore para gjykatës së shkallës së parë ato t'i ketë dhënë deklaratat a duke iu cenuar shprehje e lirë e vullnetit apo vullneti i tyre të jetë me të meta. Pra nuk është konstatuar fakti se ka pasur lajthim, mashtrim apo kanosje për t' i dhënë deklaratat e tyre trashëgimore paditësit ashtu që ato të heqin dorë prej trashëgimisë. Fakti i pohuar nga paditësit se i padituri i ka premtuar dhurim banese nuk a relevancë në anulimin e deklaratës

trashëgimore. Kjo për faktin së deklarata trashëgimore nuk mund të jepet me kusht pra nuk mund të jepet sipas premtimit të njërës trashëgimtar.”

59. Ndërsa, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 458/2020] të 16 dhjetorit 2020, theksoi si në vijim:

“Gjykata Supreme e Kosovës mbështet qëndrimin juridik të të dy gjykatave të instancës më të ulët se nuk është provuar me asnjë provë se me rastin e dhënies së deklaratave trashëgimore, paditëset kanë pasur të cenuar vullnetin e lirë dhe se ky vullnet të jetë dhënë me të meta siç është lajthimi, mashtrimi apo ekzistimi i ndonjë rrethane e cila e ka penguar ose shtrembëruar vullnetin e lirë.”

60. Nën dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kishin adresuar të gjitha pretendimet e parashtrueseve të kërkesës dhe në fund gjykatat e rregullta kishin refuzuar ankesën e tyre. Arsyet për refuzim të ankesës së paraqitur, gjykatat e rregullta i kishin bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit për Trashëgimi, që ato i kishin konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret dhe me pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtrueset e kërkesës.
61. Gjykata po ashtu vëren se gjykatat e rregullta, në vlerësimin e pretendimeve për anulimin e deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia, i janë referuar edhe nenit 135 të Ligjit për Trashëgiminë, i cili përcakton se trashëgimtarë që ka dhënë deklaratën mund të kërkojnë anulimin e kësaj deklarate, po që se ajo është dhënë me kanosje, dhunë, për shkak të mashtrimit ose lajthimit. Nën dritën e kësaj, gjykatat e rregullta konstatuan se ky nuk është rasti në situatën e parashtrueseve të kërkesës pasi këto të fundit në procedura para gjykatave të rregullta dështuan që të mbështetnin pretendimin e tyre.
62. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se përfundimet e gjykatave të rregullta e kanë trajtuar çështjen e mashtrimit me rastin e dhënies së deklaratave trashëgimore, si dhe mundësinë ligjore të anulimit të deklaratës së pëlqimit.
63. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se e kupton ndjeshmërinë e rastit, por duke marrë parasysh aspektin socio-kulturor të heqjes dorë nga trashëgimia, sikurse në rrethanat e rastit konkret, Gjykata nuk mund të trajtojë rrethanat jashtëgjyqësore në të cilat ishin përfshirë paraprakisht parashtrueset e kërkesës. Megjithatë, Gjykata vëren se pëlqimi i dhënë për heqje dorë nga trashëgimia nga ana e parashtruesve të kërkesës në rrethanat e sipër cekura ka prodhuar efekte juridike edhe në kuadër të procedurës gjyqësore të zhvilluar në rastin konkret.
64. Prandaj, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta i kanë shqyrtuar rrethanat ligjore të rastit, duke përfshirë pasojat juridike të dhënies së pëlqimit për heqje dorë nga trashëgimia nga parashtrueset e kërkesës, dhe kanë vërtetuar faktet relevante mbi validitetin e deklaratës trashëgimore nga ana e parashtrueseve në procedurën e zhvilluar më 27 prill 2005 në Gjykatën Komunale.
65. Gjykata po ashtu vëren se parashtrueset e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta, gjatë zgjidhjes së rastit të tyre, vendimet e tyre gabimisht i kishin bazuar në nenet 20, 21 dhe 36 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike të vitit 1980 (GZ e RSFJ nr. 6/80), dhe nenin 93 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore me arsyetimin se rasti nuk kishte të bënte me vërtetim pronësie por me anulim të deklaratës trashëgimore.
66. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se parashtrueset e kërkesës me rastin e inicimit të padisë në vitin 2015 para Gjykatës Themelore, përveç kërkesës për anulim të

deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia, ato kishin kërkuar edhe vërtetim të pronësisë me ¼ pjesës ideale të ngastrave kadastrale [717011]; [7170/2]; [7244]; dhe [716911].

67. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre në kontekst të refuzimit të kërkesës për vërtetim të pronësisë ishin bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike të vitit 1980 (GZ e RSFJ nr. 6/80), dhe nenin 93 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, që ato i kishin konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret dhe me pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtrueset e kërkesës. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore kishin sqaruar kushtet ligjore për fitimin e pronës së pretenduar.
68. Gjykata vë në pah qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë konstatimit të fakteve apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për atë që ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih *mutatis mutandis* rastin e Gjykatës Kushtetuese, *KI86/11*, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
69. Gjykata gjithashtu sjellë në vëmendje pretendimin e parashtrueseve të kërkesës se gjykatat e rregullta kanë shkelur parimin e paanshmërisë gjatë vendimmarrjes me arsyetimin se: “...nuk janë vlerësuar në parimin e barazisë në mes provave deklaratat e paditëseve të dhëna në procedurën e shkallës së parë, duke cenuar paanshmërinë e Gjykatës dhe duke i dhënë relevancë vetëm deklaratimit të të paditurit, përkatësisht duke u thirrur në rrethana se nuk paska pasur të meta në vullnetin e paditëseve [...]”.
70. Gjykata thekson se fakti i thjeshtë që palët janë të pakënaqura me rezultatin si dhe refuzimin e ankesës së tyre nuk është tregues i mungesës së paanshmërisë në rrethanat e rastit konkret (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Khodorkovskiy dhe Lebedev kundër Rusisë* (nr.2) 2020, Aktgjykim i 14 janarit 2020, paragrafi 430).
71. Për më tepër, fakti i thjeshtë që një trup gjykues ka marrë tashmë vendime të pafavorshme nuk mund të konsiderohet në vetvete si shqetësim i justifikueshëm për paanshmërinë e tij sepse: (i) nuk ka asgjë në shkresat e lëndës që sugjeron se trupi gjykues i gjykatave të rregullta kanë shprehur qëndrim armiqësor apo vullnet të keq ndaj parashtrueseve të kërkesës; dhe se (ii) nuk kanë shprehur paraprakisht opinion lidhur me rezultatin e rastit të tyre.
72. Gjykata më tej vëren se parashtrueset e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtrueseve të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, rastin e GJEDNJ-së, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin *KI56/17*, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

73. Rrjedhimisht, pretendimi për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës duhet të refuzohet si qartazi i pabazuar.

Pretendimet për shkelje të së drejtës së pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës

74. Gjykata fillimisht thekson se pretendimi për afatshmerine e padisë është trajtuar edhe ne kuadër të pretendimit për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
75. Në lidhje me pretendimin për shkelje të së drejtës së pronës, parashtrueset e kërkesës pretendojnë se vendimet e gjykatave të rregullta, të cilat rezultuan në refuzimin e kërkesës për anulim të deklaratës së heqjes dorë nga trashëgimia, kanë privuar ato nga të drejtat pronësore mbi pasurinë që iu takon në cilësinë e trashëgimtareve të H.T., të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
76. Gjykata vëren se parashtrueset e kërkesës në këtë kontekst theksojnë se: *“Është shkelur neni 46 1.2.3 i Kushtetutës sepse e drejta e pronës është e garantuar me Kushtetutë dhe shfrytëzimi i saj rregullohet me ligj të cilat në këtë procedurë nuk janë zbatuar ndaj paditësve duke u privuar arbitrarisht nga prona”*.
77. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se pretendimet kryesore të parashtrueseve të kërkesës në thelb kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave pronësore, si pasojë e mosanulimit të deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia nga ana e gjykatave të rregullta, e cila, sipas tyre, ishte dhënë nën premtimin dhe për pasojë rezultoi në heqje dorë përfundimtare nga trashëgimia e babait të tyre H.T. në favor të vëllait të tyre.
78. Gjykata vëren se parashtrueset e kërkesës, me rastin e inicimit të padisë në vitin 2015 para Gjykatës Themelore, përveç kërkesës për anulim të deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia, ato kishin kërkuar edhe vërtetim të pronësisë mbi pronën, përkatësisht në një pjesë të ngastrës kadastrale [nr. 7170-4], duke u thirrur në të drejtat trashëgimore.
79. Përkitazi me këto pretendime, përkatësisht lidhur me pretendimin për shkelje të të drejtave pronësore mbi bazën e trashëgimisë, Gjykata thekson se të njëjtat janë trajtuar nga gjykatat e rregullta.
80. Ndaj pretendimeve të lartpërmendura, Gjykata Themelore kishte theksuar si në vijim:

“[...] Gjykatës i rezultoi se pretendimi i paditësve për të anuluar deklaratën trashëgimore dhe për të fituar të drejtën e pronësinë në një pjesë të ngastrës kadastrale nr.7170-4 ZK Prizren, në bazë të trashëgimisë së lënë nga paraardhësi i këtu palëve ndërgjyqëse Hyda Temo, është plotësisht i pabazë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të cilat i kemi përmendur më lart. Gjykata vlerëson se në rastin konkret konform nenit 322.2 të LPK-së i cili përcakton se "Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provoj faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër", barra e provës bie mbi palën paditëse, kjo edhe bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, i cili përcakton se "Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla (Narra mihi factum, daba' tibi ius) dhe nga kjo rrjedh se pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim, që në përputhje me ligjin, të provoj faktet mbi të cilat e bazon pretendimin e saj, e në këtë rast paditëset me asnjë provë nuk i kanë argumentuar pretendimet e tyre.

Përkundër të lartcekurave, gjykata erdhi në përfundim se kërkesa e paditëseve për të kërkuar vërtetimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë është parashkuar [...].”

81. Ndërsa, GJykata e Apelit në kontekst të këtij pretendimi kishte theksuar si në vijim:

“Edhe sa i përket kërkesëpadisë së paditësve për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi bazë të trashëgimisë drejt është konstatuar gjendja faktike, pasi që kërkesa e kësaj natyre mbi këtë bazë është parashkuar. Krejt kjo si rezultat i faktit se paditëset nuk e kanë ushtruar me kohë padinë.

[...] Paditëset padinë në gjykatë të shkallës së parë e kanë dorëzuar me datën 18.08.2015. Ndërsa aktvendimi i trashëgimisë është bërë i formës se prere me datë 27.04.2005, dhe prej kësaj date i padituri ka qene posedues me mire besim, pasi që kur është rregulluar trashëgimia paditëset e kane dhënë deklaratën trashëgimore se heqin dore nga trashëgimia. Pra padi është parashtruar pas kalimit të afatit 10 vjeçar i paraparë me dispozitën e nenit 138 para.1 dhe 2 të Ligjit për trashëgimin të Kosovës.”

82. Në fund, GJykata vë në dukje edhe konstatimin e GJykatës Supreme [Rev. nr. 458/2020], e cila në trajtim të këtij pretendimi kishte theksuar se: *“Në këso rrethana kur kanë kaluar më tepër se 10 vjet paditëset e kanë humbur afatin për mbrojtje ligjore në kuptim të nenit 138, paragrafi 1 dhe 2 të LTK-së”.*

83. GJykata vëren se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta në kontekst të pretendimit të parashtrueseve të kërkesës për shkelje të të drejtave pronësore ofruan arsytetime konkrete, duke konstatuar se parashtrueset e kishin humbur afatin ligjor për të ushtruar padinë për vërtetim të pronësisë dhe se kishin dështuar që të mbështesin pretendimet për ekzistimin e të drejtave pronësore para gjykatave të rregullta.

84. GJykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës. Një qëndrim i tillë mbështetet katërçipërisht në praktikën e GJEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Van der Mussele kundër Belgjikës*, nr. 8919/80, paragrafi 48, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 23 nëntorit 1983). Në fakt, neni 46 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës, por kjo e fundit nuk është e drejtë absolute dhe iu nënshtrohet kufizimeve. Në rastin konkret, gjykatat e rregullta kanë shpjeguar kufizimet e pronës dhe pronësinë e pronës kontestuese në raport me kërkesën e parashtrueseve të kërkesës.

85. GJykata thekson se parashtruesi i kërkesës që ankohet për një ndërhyrje në një nga të drejtat e tij/saj pronësore duhet të tregojë fillimisht se një e drejtë e tillë ekzistonte (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Pišturová kundër Republikës Çeke*, nr. 73578/01, Aktgjykim i 24 tetorit 2004, paragrafi 38).

86. Prandaj, parashtrueset e kërkesës mund të pretendojnë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, vetëm për atë sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me “pronën” e tyre. Brenda kuptimit të kësaj dispozite, “pronë” mund të jetë “pasuria ekzistuese”, duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtrueset e kërkesës mund të pretendojnë “pritshmëri legjitime” që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore (shih rastet e GJykatës KI26/18, parashtruesi i kërkesës “*Jugokoka*” Aktvendim për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2018, paragrafi 49; dhe rastin KI156/18, parashtruesi i kërkesës *Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 korrikut 2019, paragrafi 52).

87. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se ky pretendim i parashtrueseve të kërkesës për shkelje të të drejtave të tyre pronësore, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, është qartazi i pabazuar mbi baza kushtetuese.

Pretendimi për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës

88. Gjykata vëren se përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, parashtrueset e kërkesës theksojnë se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre kanë shkelur të drejtën e tyre për barazi para ligjit me arsyetimin se nuk janë trajtuar barabartë me rastin e ndarjes së trashëgimisë.
89. Gjykata vëren se parashtrueset e kërkesës pretendimin për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës e mbështesin me pretendimin për shkelje të paragrafit 6 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], respektivisht, Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.
90. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtrueset e kërkesës theksojnë se: *“Me mosnjohjen e të drejtës në trashëgimi për këtu paditësit - vajzat e të ndjerit dhe marrjen e trashëgimisë vetëm nga vëllai është kryer diskriminim ndaj gjinisë femërore dhe shkelja e parimit kushtetues se edhe vajzat janë të barabarta në trashëgimi e me çka është shkelur edhe Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”*.
91. Gjykata, para së gjithash, rikujton se çdo pretendim i ngritur në kërkesë nga parashtruesit e kërkesave kërkon dhënien e një përgjigjeje konkrete nga ana e Gjykatës, me kushtin që kërkesa t'i përmbushë kriteret e pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Njëri ndër to është edhe ai i shterimit të mjeteve efektive juridike në procedura të rregullta pranë gjykatave të juridiksionit të rregullt.
92. Gjykata tashmë ka një praktikë të konsoliduar përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin e materies/substancës (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera rastin e Gjykatës [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), më parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 gushtit 2019, paragrafët 90-96, dhe së fundmi, rastin [KI189/19](#), parashtrues *Alban Miftaraj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 nëntorit 2019, paragrafët 49-59). Rrjedhimisht, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton detyrimin e përdorimit të mjetit juridik kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin e materies/substancës, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “substancë” para gjykatave të rregullta, në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNj. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesave i kanë shfrytëzuar ato në të dyja kuptimet, në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, [KI71/18](#), parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; [KI119/17](#), parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafin 73; dhe rastin [KI154/17](#) dhe [05/18](#), cituar më lart, paragrafin 94).
93. Aspekti i shterimit të mjeteve juridike në substancë është i përcaktuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së dhe të Gjykatës dhe nënkupton që pretendimet për shkelje të

KEDNj-së dhe të Kushtetutës duhet të jenë ngritur “të paktën në substancë” para gjykatave të rregullta në mënyrë që të njëjtave t’u jetë dhënë mundësia për të adresuar pretendimet për shkelje përkatëse (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti KI01/19, parashtrues: *Fatos Rizvanolli*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 2 shtatorit 2020, paragrafët 96-100 dhe referencat e cituara në këtë rast).

94. Në këtë drejtim, GJEDNj gjithashtu përcakton që parashtruesit e kërkesave nuk mund të lirohen nga detyrimi i shterimit të mjeteve efektive juridike, edhe nëse gjykatat e rregullta mund të kenë qenë të detyruara të shqyrtojnë vet (*ex officio*) pretendimet përkatëse (shih, për më tepër përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin e materies/substancës, udhëzuesin e GJEDNj-së, të 30 prillit 2019, Pjesa I. Bazat procedurale të papranueshmërisë; A. Mosshterimi i mjeteve juridike; 2. Aplikimi i rregullit; d. Pretendimet e Ngritura në Substancë).
95. Për më tepër, GJEDNj mban qëndrimin se mjeti juridik duhet të shfrytëzohet, për aq sa ekziston një mjet i tillë që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë të paktën në substancë argumentin për shkelje të një të drejte. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur pranë gjykatave të rregullta, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, kur ka mundur të ngrihet nga parashtruesi i kërkesës gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi kjo të cilën synon ta ofrojë rregulli për shterimin e mjeteve juridike (shih rastin e GJEDNj-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 2478/15 dhe 1787/15, Vendimi i 16 korrikut 2015, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72; dhe së fundmi rastin KI189/19, parashtrues *Alban Miftaraj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 nëntorit 2019, paragrafët 49-59).
96. Në këtë kontekst, parashtrueset e kërkesës nuk e kanë mbështetur me provë para Gjykatës, se këtë pretendimin e kanë ngritur si të nënkuptuar dhe as në materie (substancë) para gjykatave të rregullta. Prandaj, Gjykata e ka të pamundur ta trajtojë dhe analizojë tutje këtë pretendim në materie, nëse ka pasur shkelje të privatësisë, jetës private dhe familjare apo jo, ngase kërkesa në këtë pjesë nuk i përmbushë kriteret e pranueshmërisë, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, në kuptim të ngritjes së shkeljes në substancë në gjykatat e rregullta (shih, mutatis mutandis, rastin e Gjykatës KI68/21, parashtrues *Leonard Matoshi*, Aktvendimi i 3 nëntorit 2021, paragrafët -58-66).
97. Si rrjedhojë, për sa i përket këtij pretendimi, respektivisht pretendimit për shkeljen e të drejtës për barazi para ligjit, Gjykata konstaton se duhet të refuzohet si pretendim i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores se punës.

Përfundim

98. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueseve të kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese sepse parashtrueset e kërkesës nuk dëshmojnë dhe nuk mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre, dhe rrjedhimisht e njëjta nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores se punës. Në pajtueshmëri me arsyetimin e këtij Aktvendimi, kërkesa e parashtrueseve të kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, me përjashtim të njërit pretendim specifik të ngritur nga parashtrueset e kërkesës në kontekst të pretendimit për shkeljen e të drejtës për barazi para ligjit, i cili pretendim

refuzohet si i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike dhe rrjedhimisht nuk i përmbushin kriteret e pranueshmerisë, të përcaktuara me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës, më 15 nëntor 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani